

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Enver Petrovci – artisti që largohet nga jeta, por jo edhe nga skena
ADRESA	https://www.koha.net/kulture/enver-petrovci-artisti-qe-largohet-nga-jeta-por-jo-edhe-nga-skena
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 05:14:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 21:19:53 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c56ed2411fd57574be366d8e0e71bcfc087decfb2cc1edfe7acda6fe535603c6
TEKSTI	bb1b2a5992eb4182ab2516e2c6359965baaf20cc154d34a2902b451add2425a1
PAMJA	8c420b10637ac0407b46e8d598407e680a3332d6dd38a6db2796f5fc68d410f9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4d1ed4c6ef75068c2a763a0ff0575859b312b54c61a2a7596df2e157e2498636
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4d1ed4c6ef75068c2a763a0ff0575859b312b54c61a2a7596df2e157e2498636>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën Kontribuo → Letër lexuesit

KULTURË

Enver Petrovci – artisti që largohet nga jeta, por jo edhe nga skena



Të martën mbrëma Teatri Kombëtar i Kosovës ka kujtuar aktorin, regjisorin e profesorin universitar, Enver Petrovci. Në njëvjetorin e vdekjes, ai është kujtuar si artist që, pos roleve në skenë, qe edhe profesor i artit e po ashtu edhe i jetës. Enver Petrovci vdiq më 22 shtator 2025, në moshën 71-vjeçare

Nga: Shaban Maxharraj



22 shtator 2026 23:19

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Mënyra se si është përkujtuar në njëvjetorin e vdekjes, ka qenë dëshmia se artistët sikurse ai largohen nga jeta, por jo edhe nga skena. Enver Petrovci jeton në veprat që ka lënë pas, në kujtimet e shumta. Takimi përkujtimor të martën mbrëma në Teatrin Kombëtar të Kosovës, s'e ka njohur fjalën "lamtumirë", por "faleminderit". Ka qenë si një shfaqje ku rolin kryesor ai e jetën nëpërmjet gjurmëve që kanë lënë ndër gjenerata

Kur dera e sallës hapet, sikurse kur hyn publiku në një shfaqje, në "ekran" këngës ia thotë Enver Petrovci. I këndon jetës, siç ka bërë jo rrallë midis miqsh. Me të marrë fund ato sekonda të këngës, portretet e tij ndërrohen e Lulzim Lushaku luan në kontrabas. Efekti me dy palë imazhe, njëri në perden e tejdukshme e tjetri pas, bashkë me lojën në kontrabas, sikur janë intro e një shfaqjeje ku bashkohen medime të shumta. Me rreth 50 veta në sallë, kjo lloj introje ia lëshon rrugën aktore Teuta Krasniqi në rolin e moderatores.

Të martën mbrëma Teatri Kombëtar i Kosovës ka kujtuar aktorin, regjisorin e profesorin universitar, Enver Petrovci. Në njëvjetorin e vdekjes, ai është kujtuar si artist që, pos roleve në skenë, qe edhe profesor i artit e po ashtu edhe i jetës. Enver Petrovci vdiq më 22 shtator 2025, në moshën 71-vjeçare.

Ministrja e Kulturës, Saranda Bogujevci, ka thënë se gjithmonë i ka lënë përshtypje sidomos për pjesën e studentëve të tij, të cilëve u ka mësuar gjëra të ndryshme nga përvoja e tij.

"Jo veç si artist, por edhe nga përvoja e tij në jetë. Mendoj se jemi me fat që e kemi pasur dhe më vjen keq që sot nuk e kemi fizikisht pranë nesh. Por mbetet pjesë e jona e rrënjës në punën që e bëjmë në institucione", ka thënë ajo. Sipas Bogujevci, nuk qe e lehtë të lësh një emër dhe veprimtari prapa vetes, sidomos në periudhën kur Enver Petrovci ka qenë pjesë e skenës, por edhe në kohën kur ka qenë profesor.

Arbëri.

Kallas takon Kurtin e Vuçiqin: Koha për të ecur përpara

Arbëri.

Haradinaj: Këto protesta kaq të qeta po më frikësojnë, revolta po mbledhet

Arbëri.

Haradinaj: Behajdin Allaqi u përmend për të krijuar huti dhe përçarje

Kulturë.

Enver Petrovci – artisti që largohet nga jeta, por jo edhe nga skena

Arbëri.

Arrestohet në Maqedoninë e Veriut ish-luftëtar i UÇK-së, Fadil Pushkolli

Futboll.

Kosova vazhdon përgatitjet për duelin ndaj Irlandës

“Uroj shumë që në gjeneratat që vijnë të lindin njerëz si Enver Petrovci dhe të lënë gjurmë siç ka lënë ai”, ka thënë ajo.

Në emër të Fakultetit të Arteve, prodekani Zeni Ballazhi ka rrëfyer se me Petrovcin u njohën në aeroplan, duke udhëtuar për në Norvegji, në kuadër të një projekti të përbashkët, “Arti kundër dhunës”. E ka përshkruar si njohje të çuditshme dhe të bukur.

Edhe



Kulturë • 23 sht 2025

Duartrokitje në vend lamtumire për Enver Petrovcin që jetën e bëri art

“Që në takimin e parë, pata ndjesinë sikur nuk po takoja një njeri për herë të parë, por sikur po takoheshim përsëri pas shumë kohësh. Gjatë atij udhëtimi kaluam shumë mirë. Folëm, qeshëm, bashkëpunuam dhe, mbi të gjitha, e kuptuam se arti na kishte sjellë bashkë. Që nga ajo ditë, rrugët tona u kryqëzuan shumë herë”, ka thënë Ballazhi. Ka treguar se bashkëpunuan në projekte filmike e teatrore. Ka përmendur shfaqjen “Myslimani” në Teatrin Kombëtar, ku qe skenograf. Sipas tij, këto nuk janë vetëm punë që i përkasin një biografie profesionale, por edhe kujtime.

“Por Enveri për mua nuk ishte vetëm aktori i madh, regjisori apo profesori. Ishte edhe miku. Ishte ai njeri me të cilin mund të punoja seriozisht, por edhe të qeshje shumë. Dhe ndoshta ajo që e bënte Enverin të veçantë ishte mënyra se si sillej me njerëzit. Ishte i dashur me ata që e donin, por dinte të ishte i mirë edhe me ata që nuk e donin. Kjo është diçka që nuk mësohet në shkollë. Ky është karakter”, ka thënë ai. Sipas Ballazhit, kontributi i Petrovcit në Fakultetin e Arteve ishte i jashtëzakonshëm. Ka thënë se, si profesor, ai nuk u mësoi studentëve vetëm aktrimin, por edhe të guxonin, të kërkonin, të mos kënaqeshin me të zakonshmen dhe ta merrnin artin seriozisht. Në emër të Fakultetit, ai ka thënë se Petrovci kujtohet me mall, me respekt dhe me mirënjohje të pafundme.

“Mirënjohje për artin e tij. Për teatrin. Për filmin. Për studentët. Për miqtë. Dhe për të gjitha ato takime e kujtime që na ka lënë. Enveri ishte njeri i skenës. Dhe ndoshta prandaj edhe sot, kur flasim për të, kemi ndjesinë sikur ai është diku këtu. Sepse disa njerëz largohen nga jeta, por nuk largohen nga skena. Nuk largohen nga kujtesa. Nuk largohen nga njerëzit. Enver, sonje nuk po të themi lamtumirë. Po të themi: Faleminderit, Enver! Për artin”, ka përfunduar ai.

Në emër të familjes Petrovci, të pranishmëve u është drejtuar bija, Vanesa Petrovci. Sipas saj, nuk ka vend më domethënës se skena e Teatrit për ta kujtuar të atin. Ka thënë se ai e ka dashur këtë vend, sikurse gjuhën, kulturën, artin dhe njerëzit e tij.

“Por sonje për një moment dua ta lë anash Enver Petrovcin që e njeh publiku. Dua të flas për babanë. Për njeriun që, para se të jetë profesor i aktrimit e regjisor, ai ka qenë profesor i jetës. Ai na ka mësuar shumë. Na ka mësuar ta duam artin, të jemi modestë e t’i duam njerëzit. Na ka mësuar ta duam kombin e të qenit shqiptar si diçka parësore. Mbi të gjitha, na ka mësuar ta duam jetën”, ka thënë Vanesa Petrovci. Sipas saj, për vite i ati e ka përballuar një sëmundje shumë të rëndë.

“Kishte dhimbje dhe ne e shihnim. Por ai gjithmonë ka gjetur një mënyrë që të na lehtësojë me një shaka, një buzëqeshje e fjalë. Ky ka qenë babai që kemi njohur. Njeriu që edhe kur vetë e kishte të vështirë të merrte frymë, na ka dhënë frymë neve”, ka thënë Petrovci. Të pranishmit më pas me nga një pije kanë kujtuar artistin. Në mënyrën që ai festonte për jetën.



“Mendoj se jemi me fat që e kemi pasur dhe më vjen keq që sot nuk e kemi fizikisht pranë nesh. Por mbetet pjesë e jona e rrënjës në punën që e bëjmë në institucione”, ka thënë ministrja e Kulturës, Saranda Bogujevci

I lindur në Prishtinë më 28 shkurt 1954, Petrovci po në këtë qytet përfundoi shkollën fillore dhe gjimnazin. Prishtinës nuk iu nda as kur nisin mësimet për aktrim duke ndjekur Shkollën e Lartë Pedagogjike. U zhvendos në Beograd ku përfundoi Fakultetin e Arteve Dramatike më 1978. Sipas Fjalorit Enciklopedik të Kosovës me shfaqjet “Mblesëria” dhe “Martesa” të Anton Chekhov mori pjesë në të gjitha festivalet e ish-Jugosllavisë, si dhe në disa festivale ndërkombëtare. Po, sipas Fjalorit, zë i shkruar nga Besim Rexhaj, pas diplomimit Petrovci u angazhua në Teatrin Jugosllav të Dramës kurse në “Atelje 212” luajti rolin kryesor në shfaqjen “Kurora e Kosançiqit”.

“Pas kësaj shfaqjeje, në vitet ’80 u angazhua kryesisht në rolet kryesore teatrore. Me thellimin e krizës në ish-Jugosllavi, u largua nga Beogradi dhe në Prishtinë luajti shfaqjet ‘Konfiteori’, ‘Procesi’ dhe ‘Nastasja Filipovna’”, shkruhet aty. Teatrot e Dubrovnikut, Subotićës e Novi Sadit qenë po ashtu nikoqire të roleve të tij. Në fillim të viteve ’90, Petrovci do t’i kthehej Prishtinës si qytetar i saj. U zgjodh ligjërues i aktrimit dhe i diksionit në Fakultetin e Arteve në Prishtinë.

“Në vitet 1990–1993 ishte themelues dhe drejtor i teatrit “Dodona” në Prishtinë. Pas largimit nga puna në teatrin ‘Dodona’, në vitin 1994 themeloi shkollën e parë private të aktrimit ‘Actor’s Studio’ në Prishtinë”, shkruhet në Enciklopedi. Petrovci pas luftës së fundit në Kosovë themeloi edhe shtëpinë teatrore “Teatri i Babës” që nuk pati funksion të gjatë. Qe personazh i shumë filmave, e shfaqjeve teatrore. Shfaqjet si “Kush më ka faj që jam shqiptar” dhe “Të mallkuarit”, në të cilat ai është autor, regjisor dhe aktor, ishin shfaqjet e para që u realizuan në teatrin “Dodona” dhe në Teatrin Kombëtar të Kosovës menjëherë pas luftës në Kosovë.

Edhe

Shtojca për Kulturë • 28 sht 2025

Enver Petrovci nuk luante, ai nderonte praninë

Sa i përket kinematografisë së Kosovës, në vitet ’80 do të njihej për rolet e tij në filma si “Kur pranvera vonohet”, “Dhimbja krenare” dhe “Rojat e mjegullës”. Por në atë dekadë, qe goxha emër i kinematografisë jugosllave. “Hajde da se volimo 2”, “Obična priča”, “Šargarepo ti ne rasteš lepo”, “Manifesto”, “Ortaci”, “Dečji bič”, “Uvek spremne žene”, “Život u grobljanskoj”, “Jugovizija”, “Dvostruki udar”, janë disa prej filmave të asaj kohe ku Petrovci ka luajtur. Ka luajtur edhe në filma shqiptarë pas luftës së fundit.

Petrovci gjatë jetës së tij është shpërblyer me shumë çmime si Çmimi i parë në festivalin mbarëkombëtar “Aleksandër Moisiu” në Tiranë, aktori më i mirë në Festivalin e Filmit Kosovar më 2003 dhe 2004 dhe 2007 dhe aktori më i mirë në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Tiranë më 2010. Kurse në vitin 2021 ishte laureat i Çmimit për veprimtari jetësore në fushën e teatrit, çmim ky që ndahet nga Ministria e Kulturës.

#ENVER PETROVCI

#TEATRI KOMBËTAR I KOSOVËS

Artikuj të ngjashëm

Shtojca për Kulturë • 28 sht 2025

Enver Petrovci: I did it my way

EXPRESS • 23 sht 2025

Enver Petrovci - aktori, regjisor i profesori i shquar, kujtohet sonte në emisionin “Express”

Kulturë • 23 sht 2025

Enver Petrovci – aktori e pedagogu ikonë, sharmi i jetës dhe i skenës



Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.